Nr prot 397
31.3.10.



# Bankers Petroleum Albania Ltd

Lagjia "Kastrioti",

Rr. Vasil Peçuke

Fier, Albania

## Pasqyrat Financiare te Auditura

## Per periudhen kontabel e mbylluar me 31 Dhjetor 2009

## se bashku me raportin e audituesit

## Përmbledhje e Lendes

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAUR ..... 4
1. TE PËRGJITHSHME ..... 10
2. BAZAT E PERGATITJES ..... 11
3. POLITIKAT KONTABEL ..... 11
3.1 RAPORTIMI I SEGMENEVE TE BIZNESITT ..... 11
3.2 KONVERTIMI I TRANSAKSIONEVE NË MONEDHË TË HUAJ ..... 11
3.3 NJOHJA E TE ARDHRAVE ..... 11
3.4 MAKINERI DHE PAJISJE PUNE TE NAFTES DHE GAZIT, MAKINERI DHE PAJISJE PUNE TE TJERA DHE AKTIVE JOMATERIALE ..... 12
3.5 KOSTOT E KERKIM - ZHVILLIMI ..... 13
3.6 INVENTARET ..... 13
3.7 SHPENZIMET E EKSPLORIMIT ..... 13
3.8 TATIMI I SHTYRE ..... 13
3.9 TATIMI AKTUAL ..... 14
3.10 PERFITIMET E PUNONJESVE ..... 14
3.11 INSTRUMENTAT FINANCIAR DHE C'RREGJISTRIMI I TYRE ..... 14
3.11.1 AKTIVET FINANCIARE ..... 14
3.11.2 DETYRIMET FINANCIARE ..... 15
3.11.3 ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE FINANCIARE ..... 15
3.11.4 ÇRREGJISTRIMI I INSTRUMENTAVE FINANCIARE ..... 15
3.12 QERATE ..... 16
3.13 MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTËT E MJETEVE MONETARE ..... 16
3.14 PROVIZIONET ..... 16
4. MENAXHIMI I RISKUT ..... 16
4.1 MANAXHIMI RISKUT FINANCIAR ..... 16
4.2 RISKU I KREDITIMIT ..... 18
4.3 RISKU I LIKUIDITETIT ..... 18
4.4 MANAXHIMI I RISKUT TË KAPITALIT ..... 19
4.5 VLERËSIMI I VLERËS SË DREJTË ..... 19
5. ÇMUARJE DHE GJYKIME KRITIKE TË KONTABILITETIT ..... 20
5.1 MONEDHA FUNKSIONALE DHE RAPORTUESE ..... 20
5.2 SHPENZIMET E EKSPLORIMIT ..... 21
5.3 VLERESIMI I REZERVAVE TE NAFTES ..... 21
5.4 RENIA NE VLERE E AKTIVEVE ..... 21
5.5 RENIA NE VLERE E LLOGARIVE TE ARKËTUESHME ..... 22
5.6 TATIMI MBI TË ARDHURAT ..... 23
5.7 PËRFITIME TË TJERA – SHPERBLIMI ME AKSIONE ..... 23
5.8 KRAHASUESHMËRIA ..... 23
6. RAPORTIMI SEGMENTAR ..... 23
7. TE ARDHRAT NGA SHITJA ..... 24
8. SHPENZIMET PER PAGESAT KONCESIONARE ..... 24
9. SHPENZIME TE PËRGJITHSHME PRODHIMI ..... 25
10. SHPENZIME TE PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE ..... 25

11. SHPENZIME DHE TE ARDHURA FINANCIARE ..... 26
12. SHPENZIME TATIM FITIMI ..... 26
15.1 TATIM FITIMI AKTUAL ..... 27
15.2 TATIM FITIMI I SHTYRE ..... 28
13. LLOGARITE DHE VENDOSJET ME BANKAT ..... 30
14. LLOGARITE E ARKETUESHME ..... 31
15. MAKINERI. PAJISJE PUNE ..... 31
16. LLOGARITE E PAGUESHME ..... 33
17. HUA AFATSHKURTER ..... 33
18. HUAMARRJE AFATGJATE ..... 33
19. DETYRIMET PER TËRHEQJEN E AKTIVEVE ..... 34
20. TRANSAKSIONET ME PALET E LIDHURA ..... 34
21. DETYRIME DHE ANGAZHIME JASHTE BILANCIT ..... 35
22. NGJARJE PAS DATËS SE PËRPILIMIT TE RAPORTIMIT FINANCIAR ..... 35
23. RESERVAT E NAFTES ..... 35
24. SNFR DHE INTERPRETIMET NE DATEN E PËRPILIMI TE RAPORTIMIT ..... 38

# RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVAUR

Asamblesë së Ortakëve të
Bankers Petroleum Ltd – dega Shqipëri
Lagjia "Kastriot", Rr. Vasil Peçuke
Fier - ALBANIA

Tirana 30 mars 2010

*Raportim ne lidhje me Pasqyrat Financiare*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkelidhur te Bankers Petroleum Albania Ltd (ne vijim e quajtur " Dega"), te cilat perfshijne Pozicionin Financiar per vitin qe mbyllet me date 31 Dhjetor 2009 dhe pasqyrat perkatese te te ardhurave gjitheperfshirese, te ndryshimit te kapitaleve te veta dhe te fluksit te mjeteve monetare per kete ushtrim per kete vit si dhe nje permbledhje te politikave me kryesore te kontabilitetit dhe shenimet shpjeguese.

*Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare*

Drejtimi mban pergjegjesi per pregatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pregatitjen e pasqyrave financiare qe me mos permbajne anomali dhe gabime materiale, duke zgjedhur dhe aplikuar politika te pershtatshme te kontabilitetit; dhe duke bere vleresime te arsyeshme kontabel ne varesi te situates.

*Pergjegjesia e Audituesit*

Pergjegjesia e jone eshte, qe bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Auditimin e kemi kryer ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te jemi ne perputhje me kerkesat e etikes dhe qe te planifikohet dhe te kryhet auditimi per te marre sigurine e aresyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali dhe gabime materiale.

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per marre evidencat e auditimit rreth shifrave dhe paraqitjeve ne pasqyrat financiare. Keto procedura te cilat zgjidhen ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshijne vleresimin e rrrezikut te gabimeve materiale te pasqyrave fianciare, qe mund te kene ndodhur per shkak te mashtrimit ose te gabimeve. Per realizimin e vleresimit te ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare te shoqerise me qellim te hartoje procedura te auditimit te pershtatshme sipas situates, por jo me qellimin e shprehjes se nje opinioni ne lidhje me efektivitetitn e kontrollit te brendshem te shoqerise. Nje auditimin perfshin vleresimin e pershtatshmerise te politikave kontabel te perdoruara dhe arsyeshmerine e vleresimeve kontabel te bera nga drejtimi si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme qe evidenca e auditimit qe kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per tu perdorur si baze ne dhenien e opinionit tone te audituesit.

*Opinion*

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare, te marra ne teresi dhe ne te gjithe aspektet materiale, japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte te situates financiare te Bankers Petroleum Albania Ltd me 31 Dhjetor 2009, te rezultateve te veprimatarive te saj, te fluksit te mjeteve monetare per periudhen kontabel te mbyllur ne kete date, ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar.

Firma : Leze Abazi

Studio L.E.A.L Auditing

Drejtues i Auditimit

Studio L.E.A.L Auditing ah.p.k.

Date : 30 mars 2010

Addresa: Rr.Barrikadave nr 7
Tiranë –Albania
Tel: +355 4 236 536
Fax: +355 4 236 536

Bankers Petroleum Ltd – Dege Ne Shqiperi

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2009 se bashku me shenimet shoqeruese

Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

# PASQYRA E TE ARDHURAVE TOTALE GJITHEPERFSHIRESE PER PERIUDHEN QE FILLOI ME 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2009

| | | Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor | |
|---|---|---|---|
| **Pershkrimi I Llogarive** | | **2009** | **2008** |
| Te ardhurat (neto nga shpenzimet e transportit) | 8 | 7.202.148 | 8.472.040 |
| Drejta Minerare (-) | 9 | -1.950.948 | -1.898.865 |
| | | | 0 |
| | | **5.251.200** | **6.573.175** |
| **Shpenzimet Operative** | | | 0 |
| Shpenzimet e prodhimit | 10 | 2.334.228 | 2.454.731 |
| Amortizimi, zhvleresimi dhe harxhimi | | 1.505.417 | 1.130.524 |
| Shpenzimet e rritjes se vleres se prov. per largimin e AAM | | 28.806 | 20.271 |
| Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative | 11 | 428.638 | 305.687 |
| | | **4.297.089** | **3.911.213** |
| **Te Ardhurat/Shpenzimet Financiare** | | | |
| Te ardhurat financiare | 12 | 20.884 | 206 |
| Shpenzimet financiare | 12 | -192.369 | -201.709 |
| Fitim (humbje) nga kembimit valutore | 12 | -48.556 | 44.353 |
| Shpenzime te tejra Financiare | | | 0 |
| | | **-220.041** | **-157.150** |
| **Fitim (humbje) para tatimit mbi fitimin** | | **734.070** | **2.504.812** |
| **Shpenzimi I tatim Fitimit** | 13 | -727.325 | -850.541 |
| Shpenzim Tatim Fitimit Korrent | | | 0 |
| Tatim I Shtyre detyrim ( Aktiv) | | 727.325 | 850.541 |
| **Fitim (Humbje) neto** | | **6.745** | **1.654.271** |
| **Rezultati I periudhes** | | **6.745** | **1.654.271** |
| Fitime(humbje) nga kembimi trasnferuara ne Kapital | | | |
| Diferenca kembimi | | | |
| **Shuma e njohur direct ne Kapital** | | **6.745** | **1.654.271** |

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-27*

# PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR PER PERIUDHEN QE U MBYLL ME 31 DHJETOR 2009

| | | Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor | | |
|---|---|---|---|---|
| **Pershkrimi I Llogarive** | | **2009** | | **2008** |
| **Aktivet Afatshkurter** | | | | |
| Mjetet Monetare dhe te Ngjashme | 14 | 281.159 | | 68.033 |
| Llogarite e Arketueshme | 15 | 2.582.929 | | 1.618.983 |
| Inventaret | 16 | 188.881 | | 179.588 |
| Aktive te Tjera dhe paradhenie | 17 | 990.641 | | 573.116 |
| | | **4.043.610** | | **2.439.721** |
| **Aktivet AfatGjate** | | | | |
| Makineri dhe Pajisje Nafte e gazi | 18 | 13.094.325 | | 10.476.381 |
| Shpenzime Zhvillimi dhe Aktive te Patruepzuara | 18 | 1.796.229 | | 1.816.503 |
| Makineri dhe Pajisje tjera | 18 | 50.629 | | 49.344 |
| Aktive te tjera Afatgjata | | | | 0 |
| | | **14.941.183** | | **12.342.228** |
| | | **18.984.793** | | **14.781.948** |
| **Detyrime Afatshkurter** | | | | |
| Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura | 19 | 2.210.397 | | 2.513.554 |
| detyrime ndaj personelit | 20 | 18.747 | | 16.098 |
| Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH | 20 | 6.055 | | 15.060 |
| Huamarrje afatshkurter | 21 | 1.663.025 | | 1.591.777 |
| detyrime te tjera Afafshkurter dhe te ardhura te shtyra | | | | 404 |
| | | **3.898.224** | | **4.136.893** |
| **Detyrime AfatGjata** | | | | |
| Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perllogaritura | | | | 0 |
| Huamarrje Afagjate | 22 | 10.213.155 | | 6.596.784 |
| Detyrime te Tjera Afatgjata dhe te ardhura te shtyra | | | | 0 |
| Detyrime te Tjera ( Tatimi i Shtyre) | | 3.190.255 | | 2.462.930 |
| Provizione | 23 | 354.991 | | 263.918 |
| | | **13.758.400** | **0** | **9.323.631** |
| **Llogarite e Kapitalit Aksioner** | | | | 0 |
| Kapitali i paguar | | | | 0 |
| Reserva | | | | 0 |
| Fitimi( humbja) e Mbartur | | 1.328.169 | | 1.321.424 |
| | | **1.328.169** | | **1.321.424** |
| | | **18.984.793** | | **14.781.948** |

Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

# PASQYRA E NDRYSHIMIT TE FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE PER PERIUDHEN QE FILLOI ME 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2009

| | | Periudha qe u mbyll me 31 dhjetor | |
|---|---|---|---|
| **Metoda Indirekte** | | **2009** | **2008** |
| **Flukset Operative** | | | |
| **Fitimi ( humbja ) pas tatim fitimit** | | 6.745 | 1.654.271 |
| **Rregullime te flukseve operative** | | | |
| | Harxhimi, zhvleresimi, amortizimi | 1.505.417 | 1.130.524 |
| | Diferencat e konvertimit | -6.868 | -771.625 |
| | Diferencat e kembimit | -48.556 | 44.353 |
| | Te ardhura nga interesi | -20.884 | -206 |
| | Shpenzime Interesi | 192.369 | 201.709 |
| | | | 0 |
| | | | 0 |
| | | | 0 |
| | | | 0 |
| (rritje )/ pakesim ne Llogarite e Arketueshme | | -963.946 | -198.524 |
| (rritje )/ pakesim ne te tjera Llogarite e Arketueshme | | | 0 |
| (rritje )/ pakesim ne paradhenitt ndaj furnitoreve | | -104.579 | -177.756 |
| (rritje )/ pakesim ne inventaret | | -9.293 | 4.468 |
| (rritje )/ pakesim ne shpenzimet e shtyra | | -184.812 | -227.001 |
| (rritje )/ pakesim ne shpenzimet e parapaguara | | | 303.281 |
| rritje /( pakesim) ne Llogarite e Pagueshme | | -303.157 | 1.243.372 |
| rritje /( pakesim) ne Llogarite tjera pagueshme | | -128.133 | 0 |
| rritje /( pakesim) ne paradhenie te klienteve | | | 0 |
| rritje /( pakesim) ne llogarite e shtetit dhe personelit | | 720.970 | -48.715 |
| rritje /( pakesim) ne ardhurat e shtyra | | | 0 |
| rritje /( pakesim) ne interesin e arketueshem | | 20.884 | 206 |
| rritje /( pakesim) ne interesin e pagueshem | | -192.369 | -201.709 |
| Tatim Fitimi I paguar | | | 0 |
| rritje /( pakesim) ne huarmarrjet afatshkurter (OD) | | 71.248 | 281.724 |
| rritje /( pakesim) ne tatim fitimin e shtyre | | | 850.541 |
| **Flukset e Mjeteve Monetare nga aktivitetet operative** | | **555.035** | **4.088.915** |
| **Flukset e Mjeteve Monetare nga Aktivitet Investuese** | | | |
| Shpenzimet kapitale ( makineri pajisje etj) | | -3.915.041 | -5.879.677 |
| **Flukset e Mjeteve Monetare nga aktivitetet investuese** | | **-3.915.041** | **-5.879.677** |
| **Flukset e Mjeteve Monetare nga aktivitetet financuese** | | | |
| Rritje (pakesim ) I huamarrjeve afatgjata | | 17.186 | -276.900 |
| Rritje (pakesim ) I huamarrjeve nga kompania meme | | 3.555.946 | 2.064.029 |
| **Flukset e Mjeteve Monetare nga aktivitetet financuese** | | **3.573.132** | **1.787.129** |
| **Rritje / (pakesim ) I flukseve te Mjeteve Monetare** | | **213.126** | **-3.634** |
| Mjete Monetare ne fillim te periudhes | | 68.032 | 71.666 |
| **Mjete Monetare ne Fund te periudhes** | 24 | **281.159** | **68.032** |

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-27*

Bankers Petroleum Ltd – Dege Ne Shqiperi

Pasqyrat Financiar per periudhen ushtrimore qe mbyllet me 31 dhjetor 2009 se bashku me shenimet shoqeruese

Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

## PASQYRA E NDRYSHIMIT TE KAPITALIT AKSIONER PER PERIUDHEN QE FILLOI ME 1 JANAR DERI ME 31 DHJETOR 2009

| | Kapitali Aksioner | Rezerva te Konvertimit te Monedhave te huaja | Ndryshime ne Polikat Kontabel | Fitimi I Pashperndare | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja me 1 Janar 2008** | **0** | **0** | **3.262.908** | **-2.816.183** | **446.725** |
| **Rezultati i Periudhes** | | | | **874.699** | **874.699** |
| Fitime Humbje te trasnferuara ne PASH | | | | | 0 |
| Fitime Humbje te trasnferuara ne PASH | | | | | 0 |
| Diferenca nga Kembimi | | | | | 0 |
| **Shumat e Njohura direkte ne kapital** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **Rezultati neto per periudhesn qe u mbyll me 31 dhjetor 2008** | **0** | **0** | **0** | **874.699** | **874.699** |
| Rritje kapitali | | | | | 0 |
| Pagesa Dividenti | | | | | 0 |
| Ndryshime ne Diferenca konvertimi te kapitalit | | | | | 0 |
| Shperndarje e Fitimit | | | | | 0 |
| Fitimi ( Humbja) e mbartur | | | | | 0 |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2008** | **0** | **0** | **3.262.908** | **-1.941.484** | **1.321.424** |
| | | | | | |
| **Rezultati i Periudhes** | | | | **6.745** | **6.745** |
| Fitime Humbje te trasnferuara ne PASH | | | | | 0 |
| Fitime Humbje te trasnferuara ne PASH | | | | | 0 |
| Diferenca nga Kembimi | | | | | 0 |
| **Shumat e Njohura direkte ne kapital** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **Rezultati neto per periudhesn qe u mbyll me 31 dhjetor 2009** | **0** | **0** | **0** | **6.745** | **6.745** |
| Rritje kapitali | | | | | 0 |
| Pagesa Dividenti | | | | | 0 |
| Ndryshime ne Diferenca konvertimi te kapitalit | | | | | 0 |
| Shperndarje e Fitimit | | | | | 0 |
| Fitimi ( Humbja) e mbartur | | | | | 0 |
| **Gjendja me 31 dhjetor 2009** | **0** | **0** | **3.262.908** | **-1.934.739** | **1.328.168** |

*Pasqyrat financiare lexohen se bashku me shenimet shoqeruese 1-27*

*Pasqyrat Financiare se bashku me shenimet shoqeruese te Bankers Petroleum Albania Ltd – Dege ne Shqiperi jane aprovuar nga drejtimi i deges me 19.03.2010:*

*Administratori Ligjor i deges*

*Richard L. Ferguson*

*Firma*

Bankers
BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD.

*Kontabilisti i deges*

*Fred Gallani*

*Firma*

Gjatë periudhave ushtrimore 2004 deri më 2007, Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore në Shqiperi të përcaktuara në ligjin nr 7811 datë 1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", në license- marrëveshjen e hidrokarbureve si dhe në Ligjin 7661 datë 19 Janar 1991 "Për Kontabilitetin" dhe Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes së Llogarive Vjetore të aprovuara me vendim të Këshillit të Ministrave nr.334 datë 9 Korrik 1993. Në datë 29.04.2004 u miratua Ligji Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe më pas u miratuan edhe Standartet Kontabël që lidhen me të. Ky ligj i ri përcaktoi zbatimin në Shqipëri të Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (të njohura si SNRF) për të gjitha shoqëritë tregëtare, pavarësisht nga forma juridike dhe aktiviteti i tyre të cilat kanë një qarkullim vjetor të 2 viteve të fundit mbi 1.25 mil lekë dhe mbi 100 të punësuar.. Zbatimi i parë i tyre parashikohet në ndërtimin e PF për periudhën ushtrimore që përfundon më 31 Dhjetor 2008. Standartet Kontabël që do të zbatohen nga shoqëritë paraqiten si më poshtë:

(i) Bankat dhe Institucionet Financiare- të gjithë setin e SNRF dhe KNISRF përkatëse (përkthimi në gjuhen shqipe i tyre do të bëhet i mundur së shpejti)

(ii) Shoqëritë e Mëdha - të gjithë setin e SNRF dhe KNISRF përkatëse

(iii) Degët e shoqërive të huaja - të gjithë setin e SNRF dhe KNISRF përkatëse

(iv) Shoqëritë e Vogla dhe të Mesme – Standartet Kombëtare Kontabël të hartuara nga KK dhe të shpallura nga Ministri i Financave.

Dega zbatoi per here të pare SNRF per pergatitjen dhe prezantimin e Pasqyrave Financiare per periudhen ushtrimore qe perfundon ne 31 dhjetor 2008.

Ato përfshijnë standartet e aprovuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standarteve të Kontabilitetit (BNSK) dhe interpretimet e standarteve të botuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve të Standarteve të Raportimit Financiar (KNISRF) ose ish Komiteti i Përhershëm i Interpretimeve.

Dega, si një përdorues për HERE TE PARE më 31 Dhjetor 2008 ndoqi rregullat e përcaktuara në SNRF 1 për zbatimin për herë të parë të SNRF-ve nga Shoqëritë. Rakordimi (kuadrimi) i diferencave të rezultuara nga adoptimi i SNRF lidhur me Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyrën e Fluksit të Mjeteve Monetare, Pasqyrën e ndryshimit të Kapitalit të Aksioner në 1 Janar 2008 dhe 31 Dhjetor 2008 të përgatitura sipas IFRS dhe pasqyrave të përgatitura më parë në përputhje me Rregullat e Vlerësimit dhe Paraqitjes së Llogarive Vjetore në Shqipëri janë përfshirë në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2008.

## 1. Te përgjithshme

Bankers Petroleum Ltd. Dega ne Shqiperi ('Dega") është krijuar me vendimin e gjyaktës Tiranë nr. 28.06.2004 si degë e shoqërisë Bankers Petroleum , nje shoqeri kanadeze me zyra qendrore ne Cayman Island, ne vijim te ndryshimit te emrit tregetar me ane te vendimit e gjykatës së Tiranës të datës 17 dhjetor 2006. Deri ne kete date shoqeria njihej me emrin Saxon International Energy në Shqipëri.
Duke qënë se është degë e një shoqërie të huaj ajo është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare pa kapital, pasi shërben si i tillë kapitali i shoqërisë mëmë i cili sipas aktit të themelimit të saj është 2 milion USD. Bankers Petroleum, shoqeria meme, eshte nje kompani e listuar ne Bursen e Torontos dhe Tregu i Investimeve Alternative (IAM) te burses se Londres ku tregethoet me simbolin BNK.
Dega eshte e angazhuar ne kerkimin per zhvillimin dhe prodhimin e naftes dhe gazit natyror ne Shqiperi. Objekti kryesor i degës së saj në Shqipëri është kryerja e operacioneve hidrokarbure të naftës në zonat e miratuara nga marrëveshja e hoidrokarbureve, prodhimi dhe shitja e naftës dhe kryerja e çdo marrëveshje dhe aktiviteti në lidhje me hidrokarburet. Ajo e kryen aktualisht aktivitetin në Shqipëri në përputhje me Liçensë marrëveshjen e lidhur me Albpetrol sh.a.më datën 19.06.2004.
Dega operon ne Patos ne fushen e naftes ne Marinze ne vijim te nje marreveshje me Albetrol Sh.A (Albpetrol), kompania shteterore e naftes, nen licencen ekzistuese te Albetrolit me Agjensine Kombetare per Burimet Natyrore (AKBN). Lincenca ka nje afat 25 vjet me opsonin per te zgjatur marreveshjen me Kompanin e zgjedhur dhe per 5 vjete te tjere. Në përputhje me Marreveshjen Hidrokarbure dhe Liçensë Marrëveshjes shoqëria gjatë fazës së kërkimit dhe zhvillimit do të mbulojë të gjitha shpenzimet e veta si për investimet ashtu dhe ato operative me të ardhurat e mundshme nga shitja e produktit të nxjerrë.

Dega ne baze te vendimit nr 31830 të datë 28.09.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka administrator ligjor zoti Richard Ferguson, nderkaq qe struktura e saj organizative permban 4 drejtorë departamentesh: financë dhe sherbimet e kompanise, shërbimesh teknike, prodhimi, dhe kërkime gjeologjike.
Adresa ligjore e saj është në Fier, lagjia "Kastrioti", Rr. Vasil Peçuke kurse aktivitetin ekonomik e zhvillon në fushën e Patosit dhe Marinzës. Shoqëria funksionon mbështetur në statutin e shoqërisë mëmë.
Shoqëria është subjekti i regjistruar në TVSH dhe është pajisur me NIPT K43128401L dhe me kod fiskal 1000990. Me 31 Dhjetor 2009 shoqeria ka 191 punonjes (31 Dhjetor 2008, 191 punonjes). Pasqyrat Financiare jane aprovuar dhe autorizuar per t'u perdorur nga drejtimi i deges me 19.03.2010.

## 2. Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare përgatiten duke u bazuar në koston historike, me përjashtim të disa kategorive të aktiveve dhe detyrimeve, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (SNRF).

Pergatitja e pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF kerkon qe te perdoren disa vlerësime kontabël të rëndësishme. Gjithashtu kërkohet qe Drejtimi të ushtrojë gjykimin e vet përsa i përket politikave kontabël që aplikohen në kompani. Këto fusha përfshijnë një shkallë të lartë gjykimi dhe kompleksiteti, ose janë fusha ku supozimet ose vlerësimet janë të domosdoshme për pasqyrat financiare te konsoliduara.

## 3. Politikat Kontabel

### *3.1 Raportimi i Segmeneve te Biznesitt*

Një segment biznesi është një grup aktivesh dhe veprimtarish të cilat bëjnë të mundur përftimin e mallrave ose shërbimeve që janë subjekt i rreziqeve dhe përfitimeve të cilat janë të ndryshme nga ato të segmenteve të tjera të biznesit. Një segment gjeografik bën të mundur përftimin e mallrave ose të një shërbimi brenda një mjedisi të caktuar ekonomik të cilat janë subjekt i rrezikut dhe përftimeve të ndryshme nga ato të një segmenti tjetër i cili operon në mjedise të tjera ekonomike.

Dega eshte e angazhuar ne aspektet kryesore te Industrise se Naftes nxjerrjes dhe shitjes se produkteve te naftes. Bankers Petroleum drejton aktivitetin e tij nepermjet 2 segmenteve kryesor, Eksplorimin dhe Nxjerrjen e Naftes dhe veprimtaria e administrative e Deges. Informacionet e segmenteve raportohen ne perputhje me SNRF 8 *Segmentet Operativ*, e cila zevendeson SNRF 14 *Raportimi i Segmenteve*. Nuk kerkohet qe SNRF 8 te aplikohet deri me 2009.

### *3.2 Konvertimi i transaksioneve në monedhë të huaj*

*(i) Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes*

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare vlerësohen duke përdorur monedhën e mjedisit ekonomik kryesor në të cilin operon njësia ( "monedha funksionale"). Pasqyrat financiare në Shqipëri paraqiten në Lekë (All), e cila është dhe monedha e paraqitjes.

*(ii) Transaksionet dhe tepricat*

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në fund të periudhës kontabël, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin e këmbimit të kësaj datë. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "të tjera të ardhura (shpenzime) financiare".

| Date / Currency | 31 dhje 2009 | 31 dhje 2008 |
|---|---|---|
| Euro | 137.96 | 123.8 |
| USD | 95.81 | 87.91 |

### *3.3 Njohja e te Ardhrave*

Te ardhrat nga shitja e naftes se nxjerre njihen me vleren e drejte te vleres se arketuar apo qe pritet te arketohet, pas zbritjes se taksave qe lidhen me shitjen, taksave doganore dhe *detyrimeve* te ngjashme, kur risku dhe pronesia jane

transferuar dhe kur titulli i kalon klientit. Per Eksplorimin dhe Nxjerrjen kjo zakonisht ndodh kur produkti transferohet fizikisht ne nje anije , tub apo mekanizma te tjere shperndarje. Per shitjet drejt kompanive përpunuese, titulli kalon tek klienti kur produkti eshte vendosur ne bordin anijes/mjeteve te transportit ( autobote, trena) apo eshte shkarkuar nga anija, varet nga termat e marreveshjes kontraktuale. Per shitjet me shumice te naftes dhe produkteve te tjera ajo ndodh gjithashtu ne piken e shperndarejes apo te marrjes, ne varesi te kushteve kontraktuore.

### *3.4 Makineri dhe Pajisje Pune te Naftes dhe Gazit, Makineri dhe Pajisje Pune Te Tjera dhe Aktive jomateriale*

[A] Njohja Fillestare

Ne zerin Ndertesat, makinerite dhe pajisjet e puens se naftes dhe gazit , Aktivet e tjera, shpenzimet kryesore te studimeve dhe zhvillimit te Puseve, dhe aktivet jomateriale njihen fillimisht vetem ato elemente per te cilat kostoja mund te matet ne menyre te besueshme dhe pritet te sjellin perfitime ekonomike ne te ardhmen per kompanine.

Kjo perfshin kapitalizimin e kostove te *shkaterrimit dhe Restaurimit* (kthimin ne gjendjen e meparshme) te lidhura me provizionet per nxjerrjen jashte perdorimit te nje aktivi (referoju shenimit "Provizionet"), disa nga kostot e zhvillimit (referoju shenimit "Kostot e Zhvillimit").

Llogaritja e kostove per eksplorimin jane pershkruar me poshte ( referoju shenimit "Kostot e Eksplorimit"). Aktivet jo materiale perfshijne emrin e mire, koston e kapitalizuar te software-ve dhe markave. Gjate fazes se ndertimit te ndertesave, makinerive dhe pajisjeve shuma e interesit kapitalizohet si rritje ne vleren e aktivit.

Ndertesat,makinerite dhe pajisjet dhe aktivet jomateriale njihen me kosto pasi jane zbritur harxhimi , zhvleresimi i akumuluar apo ndonje renie ne vlere.

[B] Zhvleresimi, harxhimi dhe amortizimi

Ndertesat, makinerite dhe pajisjet e lidhura me prodhimin e hidrokarbureve zhvleresohen bazuar ne sasine e prodhuar kundrejt totalit te rezervave te provuara te fushes ( per me shume ne lidhje me reservat ref shen 26), pervec rasteve kur jeta e dobishme e aktiveve eshte me e shkurter se ajo e fushes se lidhur, ne keto raste per zhvlersimit e ketyre aktiveve perdoret metoda lineare.

Baza e perllogaritjes perfshin shumen fillestare te Makineri dhe Pajisje plus shpenzimet e parashikuara te zhvillimit te reservave te provuara dhe duke zbritur velren e rikuperueshme te aktivit.

Ne qoftese aktivet kane vlera jo te rendesishme apo ne rastet kur ato nuk mund te identifikohen vecmas nga njera tjetra harxhohen duke u grupuar apo amortizohen bazuar ne element si mesatarja e termave te koncesionit si dhe ne eksperiencat e meparshme ne lidhje me njohjen e rezervave te provuara.

Ndertesa, makineri dhe pajisje te tjera zakonisht jane zhvleresuar me metoden lineare ne baze te jetes te dobishme te tyre qe zakonisht eshte:

| | |
|---|---|
| Ndertesat dhe permiresimet | 20- vjet |
| Mjete Transporti | 5 vjet |
| Pajisje kompjuterike dhe te ngjashme | 4 vjet |
| Pajisje te tjera zyre | 5 vjet |

Ndertesa, makinerite dhe paisjet te mbajtura me qera financiare zhvleresohen bazuar ne termat e qerase. Aktivete e tjera jomateriale jane amortizauar me metoden lineare mbi jeten e tyre te dobishme 10 vjet.

[C] Renia ne vlere

Pervec Aktiveve per te cilat nuk jane identifikuar rezerva te provuara ( ku baza per koston e mbartur eshte shpjeguar sipas " Kostot e Eksplorimit") vlera e mbartur e ndertesave, makineriveve dhe pajisjeve kryesore te naftes dhe gazit jane testuar cdo vit per renien ne vlere te mundeshme, atehere kur ngjarjet apo kushtet e gjendjes financiare e tyre tregojne qe shuma e mbartur e ketyre aktive nuk mund te rikuperohet.

Ne Rast se per Aktivet identifikohen qe mbartin nje renie ne vleres se tyre atehere shuma e mbartur ne kontabilitet zvogelohet deri ne shumen e rekuperueshme. Shuma e rekuperueshem perfaqesohet nga shuma me e madhe midis vleres se drejte minus kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim, ku kjo e fundit eshte llogaritur si vlera e skontuar e flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te rregulluara nga faktoret e riskut qe mbartin.

Per kete arsye grupohen sipas aftesise se tyre per te gjeneruar flukse hyrese te parase bazuar ne faktin qe keto aktive jane te identifikueshem vecmas dhe qe gjenerojne flukse te rendesishem mjetesh monetare. Aktivet e klasifikuara si te mbajtura per shitje jane njohur me vleren me te voglen ndermjet vleres se mbartur dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Nuk ngarkohet asnje tjeter provizion per zhvlersimin per aktive te tille.

Vleresimet e flukseve te ardhshem te parase te perdorur ne vleresimin e renies ne vlere te aktiveve te lidhura me prodhimin e hidrokarbureve kryhet duke perdorur vlersimin e riskut ne fushat dhe performancen e rezervave dhe perfshijne pritjet ne lidhje me rezervat e provuara dhe sasive te paprovuara, te cilet vihen ne raport me riskun qe mbartin, duke perdorur rezultatet nga projektet gjeologjike, te prodhimit, te perpunimit dhe faktoret ekonomike. Zbritja ne Vlere e aktiveve, pervec emrit te mire, aplikohet sa here qe ngjarjet qe kane cuar ne kete renie te vlereses ndryshojne. Shtimet apo pakesimet e renies ne vlere raportohen se bashku me zhvlersimin, harxhimin, dhe amortizimin.

[D] Detyrimet per terheqjen e aktiveve

Vlera e drejte per detyrimin e vleresuar per terheqjen e aktivev eshte kapitalizuar tek ndertesat, makinerite dhe pajisjet ne periudhen kur ka lindur detyrimi. Detyrimet per terheqjen perfshijne ato detyrime ligjore ku kompanise do ti kerkohet te terheq aktivet e prekshme afatgjate te tilla si puset dhe pajiset prodhuese. Kostot e aktiveve te terhequra per pajisjet e gazit dhe naftes jane amortizuar si pjese e harxhimit dhe zhvleresimit duke perdorur metoden e sasive te prodhimit. Rritjet e detyrimeve per terheqjen e aktiveve si rezultat i kalimit te kohes jane rregjistruar si shpenzime ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Shpenzimet e terheqjes kur ndodhin pakesojne ne debi detyrimin per terheqjen e aktiveve.

### *3.5 Kostot e Kerkim - Zhvillimi*

Kostot e Zhvillimit kapitalizohen si aktiveve afatgjata te patrupëzuara kur pritet qe ato te gjenerojne te ardhura ne te ardhmen. Te gjitha kostot e tjera te Kerkim – Zhvillimit i ngarkohen rezultatit kur ato rrjedhin, përveç rasteve te përmirësimit te ndërtesave dhe pajisjeve te tjera te cilat kane nje mundesi përdorimi alternativ.

### *3.6 Inventaret*

Inventari i naftes bruto eshte vleresuar me me te vogel ndermjet kostos mesatare te prodhimit dhe vleres neto te realizueshme .

### *3.7 Shpenzimet e Eksplorimit*

Dega perdor metoden e perpjekjeve te sukseshme per kontabilizimit e shpenzimit te eksplorimit te naftes. Shpenzimet e Eksplorimit kur ndodhin i ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenziemeve, pervec shpenzimeve per shpime te eksplorimit qe jane perfishire ne kostot e prones, makinerive dhe pajisjeve, ne pritje te percaktimit te rezervave te provuara.

Shpenzimet per shpimet e eksplorimit te kapitalizuar me te vjetra se 12 muaj jane kaluar ne shpenzime vetem kur (a) rezervat e provuara jane regjistruar ose (b) (i) jane gjetur sasi rezervash te prodhueshme dhe (ii) ato jane objekt i kerkimeve te metejshme ose aktiviteteve te vleresimit nderkohe qe shpimi i puseve te tjera per eksplorim eshte ne vazhdim ose i planifikuar per nje te ardhme te afert ose aktivitete te tjera jane duke u ndermarre ne menyre qe rezervat te behen te aksesueshme dhe te arrihet vlefshmeria operative dhe ekonomike e projektit.

### *3.8 Tatimi i shtyre*

Tatimet e shtyra llogariten ne perputhje me metoden e detyrimeve per tatim fitmin ne baze te dispozitave dhe ligjeve qe jane ne fuqi ne daten e bilancit kontabel.Tatimi i shtyre njihet per te gjitha diferencat qe lindin midis bazes se taksueshme te akiveve dhe detyrimeve te njohura ne Pasqyrat Financiare dhe vleres se tyre te mbartur (diferencat e perkohshme); tatimi i shtyre nuk njihet pergjithsisht ne njohjen fillestare te nje aktivi apo pasive ne nje trasaksion qe nuk ka ndikim as ne fitimin kontabel as ne fitimin e tatueshem. Aktivet per tatimet e shtyra njihen atehere kur ka

sguri se do te realizohen perfitime nga tatimi ne te ardhmen. Aktivet dhe detyrimet per tatimet e shtyra nuk skontohen dhe ato paraqiten te ndara ne Bilancin Kontabel pervec kur bie ne kontrast me ligjet ne fuqi.

### *3.9 Tatimi aktual*

Norma aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet bazuar në ligjet për tatimet që janë në fuqi në datën e ndërtimit të bilancit kontabël ne lidhje me shoqerite qe kryejne aktivitetin ne fushen e hidrokarbureve. Manaxhimi vlerëson periodikisht gjendjen lidhur me tatimin e rimbursueshëm duke u bazuar në situatat në të cilat rregullimet tatimore që zbatohen janë subjekt i interpretimit dhe përcakton provizione kur e shikon të përshtatshme bazuar në shumat që parashikon ti paguajë ndaj zyrës së tatimeve.

### *3.10 Perfitimet e punonjesve*

*A Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore*

Dega paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat bëjnë të mundur përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë është pëgjegjëse për të përcaktuar vlerën minimale për efekt të llogaritjes së sigurimeve shoqërore për qëllime të pensionit duke u bazuar në një skemë të pensioneve me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Degës në skemën e përfimit të pensionit regjistrohen si shpenzime kur ato përllogariten.

*B Përfitime të tjera të punonjësve- Shperblimi me Aksione*

Plani i shpërblimit me Aksioneve te Performances është vlerësuar me vlerën e drejte ne datën e dhënies duke përdorur metodën e përcaktimit te çmimit, Black Scholes, dhe është njohur si një shpenzim nga data e periudhës ne te cilen miratohet opcioni duke cuar ne nje rritje te tepricës se kontribuar. Ne momentin e ekzekutimit te opsionit, shumat e marra se bashku me shumat e njohura me pare si teprica te kontributit njihen si nje rritje ne detyrimin ndaj Kompanise Meme.

### *3.11Instrumentat financiar dhe c'rregjistrimi i tyre*

Dega përdor instrumenta financiare për të manaxhuar dhe zvogëluar rrezikun e ekspozimit ndaj luhatjeve të normave të interesit dhe kurseve të këmbimit të monedhave.

#### 3.11.1 Aktivet financiare

Dega i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: Huadhëniet dhe të Arkëtueshmet të cilat klasifikohen në Llogaritë e arkëtueshme, ndërsa Investimet klasifikohen si të mbajtura deri në maturim. Manaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare.

*A. Hua dhe Paradhënie*

Huatë dhe Paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativ me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk kuotohen në një treg aktiv, përveç rasteve kur: (a) ato që Dega planifikon ti shesë menjëherë ose në afatshkurtër, të cilat janë të klasifikuara si te mbajtura per tregtim, dhe ato që Dega që në momentin e parë i klasifikon si vlerë e drejtë përmes fitimit ose humbjes; (b) ato që Dega i kalsifikon si të disponueshme për shitje; ose (c) ato që mbajtësit nuk mund të rikuperojë tërësisht gjithë vlerën e investimit fillestare, përveç rastit të përkeqësimit të indeksit të creditit.

Huatë dhe Paradhënie njihen kur Dega u bë pjesë e një marrëveshjeje kontraktuale. Huatë dhe Paradhëniet fillimisht maten me kostot duke përfshirë çdo transaksion kostoje të ndodhur, ndërsa më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

*B. Llogari të Arkëtueshme*

Llogari të Arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njësia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë para. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen me koston e amortizuar pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Llogaritë e Arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për rënie të vlerës.

C. *Investimet te mbajtura deri në maturim*

Investimet e mbajtura deri në maturim jamë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturim të fiksuar, për të cilat Drejtimi ka qëllimin pozitiv dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Nëse Dega do të shiste një vlerë të rëndësishme të aktiveve të mbajtura deri në maturim, atëherë e gjithë kategoria do të riklasifikohet si te disponushme për shitje.

Investimet e mbajtura deri në maturim njihen në datën e marreveshjes dhe maten me koston fillestare duke përfshirë të gjitha transaksionet me kosto për këtë aktiv. Më pas maten me koston e amortizuar minus çdo humbje nga zhvlerësimi,nese ka. Kosto e amortizuar matet me metodën e normës efektive të interesit. Primi dhe vlerat e skontuara, duke përfshirë kostot fillestare të transaksionit, përfshihen në vlerën e mbartur të instrumentit përkatës dhe amortizohen duke u bazuar në normën efektive të interesit të instrumentit, kur aplikohet.

### 3.11.2 Detyrimet financiare

Dega i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: Llogari të pagueshme dhe detyrime financiare.

**A. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**B. Huamarrja**

Huamarrja njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se Dega ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

### 3.11.3 Zhvlerësimi i Aktiveve Financiare

**A. Aktivet e mbartura me koston e amortizuar**

Dega vlerëson në çdo datë të bilancit nëse ka evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet dhe humbjet e zhvlerësimit ndodhin vetëm nëse ka evidenca objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit ( një 'ngjarje humbjeje') dhe që një ngjarje humbjeje (ose disa ngjarje) kanë ndikim mbi flukset monetare të parashikuara të aktivit dhe që mund të vlerësohet me efektivitet. Periudha përkatëse mes një humbjeje dhe identifikimit të saj përcaktohet nga drejtimi. Në përgjithësi, periudhat e perdorura variojnë nga tre në 12 muaj; në raste të veçante përdoren periudha më të gjata. Nje provizion per renie vlere te Huave dhe Llogarive te arketushme krijohet atehere kur eshte evidente qe Dega nuk do te jete ne gjendje qe t'i arketoj te gjitha shumat ashtu sic ishte parashikuar ne termat fillestare të Huave dhe të Llogarive të Arkëtueshme. Konsiderohen tregues te renies se Vleres se Huave dhe Llogarive te arketueshme: Veshtiresi te rendesishme financiare te debitorit, ndoshta debitori ka hyre ne rrugen e falimentimit ose riorganizimit financiar, dhe moskryerja apo vonesat ne pagesa. Shuma e provizionit është diferenca mes vlerës së mbartur të aktivit dhe vleres aktuale te flukseve te parashikuara te ardhshme te parave, të skontuara me normën origjinale efektive të interesit. Vlera e mbartur e aktivit zvogelohet duke perdorur nje llogari Zbritje te vleres, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ne zerin e shpenzimeve te shitjes dhe administrimitnë. Kur ndonje Hua ose Llogari e Arkëtueshme nuk mund te arketohet, ajo crregjistrohet ne debi te Llogarise Zbritje te vleres dhe ne kredi te llogarise te arketueshme. Nese me pas arketohet shuma te cilat jane crregjistruar , atehere kreditohen shpenzimet e shitjes dhe administrimit per keto shuma.

### 3.11.4 Çrregjistrimi i Instrumentave Financiare

Një aktiv financiar sipas përkufizimit të SNK32 "Instrumentat financiare: Shënimet shpjeguese dhe Paraqitja" çrregjistrohet pjesërisht ose totalisht (nuk paraqitet më në bilancin kontabël) në rastin kur Dega parashikon që nuk do gjenerohen më flukse parash nga ky aktiv dhe nuk ka më kontrollin mbi aktivin ose ka transferuar të gjitha

rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivin. Kur kemi te bëjmë me mosarkëtim nga klienti, në rastin e Llogarive të arkëtueshme, dhe kryejmë një transferim të gjithë risqeve dhe shpërblimeve që lidhen me pronësinë, atëhere kjo llogari klasifikohet për një transferim, duke bërë të mundur kështu që kjo Llogari e arkëtueshme të jetë e vlefshme për çrregjistrim, duke supozuar që pagesa me vonesë përbën një risk të parëndësishëm. Një interpretim më i ngushtë i konceptit të "transferim thelbësor i rreziqeve dhe përfitimeve" mund të vendosë në pikëpyetje trajtimin kontabël që është adoptuar.

### *3.12 Qerate*

Dega, kryesisht hyn në marrëveshje për qira operative. Pagesat totale te kryera sipas kontratës së qirasë operative regjistrohen si shpenzime të periudhës duke u shpërndarë përgjatë jetëgjatësisë së kontratës, duke u bazuar në metodën lineare, dhe paraqiten në zërin e shpenzimeve operative. Kur qiraja operative përfundon përpara afatit të qirasë, çdo pagesë që i bëhet qiradhënësit në formën e penaliteteve për mbylljen e kontratës përpara afatit, regjistrohet si shpenzim në periudhën kur ndodh përfundimi i kontratës.

### *3.13 Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare*

Në përputhje me SNK 7 "Pasqyra e fluksit të Mjeteve Monetare", Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrat e fluksit të Mjeteve Monetare përfshin paranë (arkëtimet në para dhe depozitat me afat) dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare (investimet afat-shkurtra të cilat janë shumë likuide dhe menjëherë të konvertueshme në një vlerë që njihet me siguri dhe vlera e të cilave ndryshon shumë pak) Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në pasqyrën e fluksit të Mjeteve Monetare nuk përfshin investimet në letrat me vlerë të listuara, investimet me një datë maturimi fillestare afati i të cilës është mbi tre muaj dhe pa një klauzolë përfundimi më të hershëm të këtij afati, ose llogaritë bankare që kanë kufizime në përdorim, kufizime këto të ndryshme nga ato të cilat janë si pasojë e rregullimeve specifike në një shtet ose sektorë të aktiviteteve (kontrollet e këmbimit, etj).

Overdraftet bankare konsiderohen si financim dhe si rrjedhim përjashtohen nga Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare në bilancin kontabël korrrenspondojnë me Mjetet Monetare dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

### *3.14 Provizionet*

Provizionet jane detyrime qe perfaqesojne shuma per te cilat koha e lindjes se shpenzimeve te ardhshme jane te pasigurta. Provizionet njihen ne daten e ndertimit te bilancit per vleren e tashme te shpenzimeve qe kerkohen per percaktimin e detyrimit duke perdorur flukseve te ardhshme te parase te rregulluara me riskun. Shumat e periudhave te ardhshme skontohen duke perdorur normen e skontimit. Detaje specifike per *shkatërrimin dhe Restaurimit te ambientit* jane pershkruar me poshte. Shumat per provizionet e mbajtura rishikohen rregullisht dhe axhustohen per fakte e reja apo ndryshimet ne ligj ao teknologji. Provizionet per *shkatërrimin dhe Restaurimit te ambientit* jane kryesisht shuma qe perllogariten per pajisjet e prodhimit te hidrokarbureve, bazuar ne kerkesat e tanishme te teknologjise, niveleve te cmimit dhe vlera e tashme eshte llogaritur duke perdorur skontimin e shumave mbi jeten e dobishme ekonomike te aktiveve (Koncesionit).

Detyrimi njihet (se bashku me shumat korresponduese si pjese e pronave, makinerive dhe paisjeve te lidhura) atehere kur nje obligim (ligjor ose kontraktual) vertetohet ne periudhen, ne te cilen mund te behet nje vleresim i arsyeshem. Matja e detyrimit eshte bazuar ne kerkesat ligjore dhe teknologjia ekzistuese. Provizionet jane percaktuar ne menyre te pavarur nga vlera e përfitimeve nga sigurimi perkates.

## 4. Menaxhimi i Riskut

### *4.1 Manaxhimi riskut financiar*

Aktivetitet e Degës janë të ekspozuara ndaj një shumëllojshmërie risqesh financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe manaxhimin e disa shkallëve të riskut ose kombinime të risqeve. Marrja përsipër e riskut është thelbësore për bizneset financiare, dhe risqet operacionale janë pasoja të paevitueshme e të qënurit biznes. Prandaj, qëllimi i Degës është të arrijë një balancë të përshtashme midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet potenciale të kundërta në performancën financiare të Degës. Manaxhimi i riskut zbatohet nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Finances. Ky department identifikon, vlerëson dhe mbrohet ndaj risqeve financiare në

bashkëpunim të ngushtë me Drejtuesin e Degës. Dega zbaton parimet në lidhje me manaxhimin e riskut të përgjithshëm dhe politikat e shkruara që mbulojnë fusha të specifike, të tilla si risku nga kursi i këmbimit, risku i normave të intersit, risku i kreditimit, risku operacional etj.

Bordi i Drejtoreve te kompanise meme ka te gjithe pergjegjesine per perpilimin dhe aprovimin e politikave te manaxhimit te riskut. Bordi ka implementuar dhe monitoron zbatimin e politikave te manaxhimit te riskut duke vendosur limitet perkatese te riskut dhe kontrollon dhe monitoron risqet me kushtet e tregut dhe te aktivitetit te kompanise.

Llojet më të rëndësishme të risqeve të Degës janë risku i kreditimit, risku i likuiditetit, risku i tregut dhe risqet e tjera operacionale. Risku i tregut përfshin riskun e monedhës, riskun e normës së interesit dhe riskun e inflacionit.

### A. Risku i tregut

Dega është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, i cili është risku që vlera e drejtë e flukseve të ardhshme të Mjeteve Monetare të një instrumenti financiar do të jenë të luhatshme për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Risqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në normat e interesit, produktet e monedhës dhe të kapitalit, ku të gjitha janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut dhe ndryshimeve në nivelin e paqëndrueshmërisë të normave të tregut ose çmimeve të tilla si normat e interesit, spredi i kreditimit, normat e kursit të këmbimit dhe çmimi i kapitalit. Ekspozimi i Degës ndaj riskut të tregut lind nga portofolet e patregëtueshme. Portofolet e patregëtueshme përbëhen nga risqe të kursit të këmbimit që lindin nga llogaritë e arkëtueshme të Degës dhe Huamarrja.

*- Risku i kursit të këmbimit*

Dega ekspozohet ndaj efekteve të luhatjeve të normave ekzistuese të kursit të këmbimit në pozicionin e saj financiar dhe flukset e Mjeteve Monetare. Risqet e kursit të këmbimit lindin kur transaksionet e ardhshme tregëtare ose aktivet ose detyrimet e njohura janë të shprehura në një monedhë e cila nuk është monedha funksionale e Degës LEK. Dega ka njohur respektivisht në fund të periudhës 2009 18,9 Mil leke Aktive në USD (2008; 14 Mil lek), detyrime në USD në shumën 15,1 Mil Lek (2008; 12,451 Mil lek) me një Normë mesatare të kursit të këmbimit 1 USD = 95 lek ( 2008: 82 Lek).

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2009 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **LEK** | **USD** | **Euro** | **Other** | **TOTAL** |
| Aktivet Afatshkurter | 191.191 | 3.852.420 | 0 | 0 | 4.043.611 |
| Aktivet Afatgajte | 0 | 14.941.183 | 0 | 0 | 14.941.183 |
| **Total** | **191.191** | **18.793.602** | **0** | **0** | **18.984.793** |
| Detyrimet Afashkurter | 24.802 | 3.873.422 | 0 | 0 | 3.898.224 |
| Detyrimet afatgjate | 3.190.255 0 | 10.568.146 0 | 0 0 | 0 0 | 13.758.400 |
| Kapitali aksionr | 0 | 1.328.169 0 | 0 | 0 | 1.328.169 |
| **Total** | **3.215.057** | **15.769.736 0** | **0** | **0** | **18.984.793** |
| **GAP me 31 dhjetor** | **-3.023.866** | **3.023.866 0** | **0** | **0** | **0** |

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2008 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **LEK** | **USD** | **EURO** | **Other** | **TOTAL** |
| Aktivet Afatshkurter | 320.267 | 2.119.452 | 0 | 0 | 2.439.719 |
| Aktivet Afatgajte | 0 | 12.342.228 | 0 | 0 | 12.342.228 |
| **Total** | **320.267** | **14.461.680** | **0** | **0** | **14.781.948** |
| Detyrimet Afashkurter | 31.562 | 4.105.331 | 0 | 0 | 4.136.893 |
| Detyrimet afatgjate | 2.462.930 0 | 6.860.702 0 | 0 0 | 0 0 | 9.323.632 |
| Kapitali aksionr | 0 | 1.321.424 0 | 0 | 0 | 1.321.424 |
| **Total** | **2.494.492** | **12.287.457 0** | **0** | **0** | **14.781.948** |
| **GAP me 31 dhjetor** | **-2.174.224** | **2.174.223 0** | **0** | **0** | **0** |

- *Norma e interesit te fluksit te Mjeteve Monetare dhe vleres se drejte*

Dega ka detyrime te rendesishme qe mbartin interes, nderkaq qe flukset e parase nuk jane thelbesisht te varura nga ndryshimi i normave te interesit.

- *Risqe te tjera të Çmimit*

A. Risku i Çmimit të karburantit ( naftes)

Dega eshte e ekspozuar ndaj riskut te cmimit te naftes. Per te minimizuar kete risk cmimi i shitjes se naftes percaktohet ne baze te nje formule e cila ka per baze cmimin e Burses se mallrave ( Brent Oil prices ) plus/ minus elemente te cilet ndikohen nga cilesia e naftes krudo qe ajo nxjerr. Keto elemente jane te aprovuar nga Bordi i Drejtoreve dhe aplikohen nga departamenti i shitjeve , nderkaq qe aplikimi i sakte i tyre monitorohen nga Drejtimi i pergjithshem i Deges.

### *4.2 Risku i kreditimit*

Dega ekspozohet ndaj riskut të kreditimit, i cili është risku që një palë e tretë do të shkaktojë një humbje financiare për Kompaninë duke mos paguar detyrimin. Risku i kreditimit është më i rëndësishmi ndaj të cilit përballet Dega: si rrjedhim Drejtimi duhet ta manaxhojë me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kreditimit. Risku i kredimit lind parimisht në aktivitetet e shitjes që sjellin si rezultat të drejta për t'u arkëtuar, dhe aktivitetet e investimit që sjellin Tituj të tjerë në portofolin e aktiveve të Degës. Manaxhimi dhe kontrolli i riskut të kreditimit është i centralizuar në departamentin e Financës të Degës dhe raportohet tek Drejtuesi i Degës. Risku i kreditimit lind nga paratë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare, depozitat në bankë dhe institucionet financiare, si dhe ekspozimi i kreditimit ndaj klientëve, duke përfshirë kërkesat për t'u arkëtuar dhe angazhimet në transakione. Për bankat dhe institucionet financiare, merret në konsideratë Vlerësimi i pavarur i bankës ose i Kompanive Mëmë. Nëse nuk ka vlerësim të pavarur, kontrolli i riskut vlerëson cilënë e kreditit të klientit, duke marrë parasysh pozicionin e tij financiar, përvojën e kaluar dhe faktorë të tjerë. Limite individuale të riskut vendosen duke u bazuar në klasifikimet e brëndshme ose të jashtme në përputhje me limet e përcaktuara nga Dega. Respektimi i limiteve të kreditit monitorohet vazhdimisht. Më poshtë jepet një listë ekspozimi krediti; për më tepër informacion për këtë lloj ekspozimi që mbartin këto zëra referojuni shënimeve 14, 15

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor | |
|---|---|---|
| | **2009** | **2008** |
| Arka dhe Llogari prane Bankave | 281.159 | 68,033 |
| Llogarite e Arketueshme | 2.582.929 | 1,618,983 |
| **Total** | **2.864.088** | **1,687,016** |

### *4.3 Risku i likuiditetit*

Manaxhimi i kujdeshëm i likuiditetit nënkupton mbajtjen gjendje të një sasie të mjaftueshme të Mjeteve Monetare dhe letrave me vlerë të tregtueshme, disponueshmëri fondesh nëpërmjet shumave të përshtatshme për angazhimet për kredidhënien dhe aftësinë për të mbyllur pozicionet në treg. Për shkak të natyrës së biznesit, Dega është fleksibël në fondet e saj duke mbajtur gjendje paraje të mjaftueshme. Nje paraqitje e Aktiveve dhe detyrimeve sipas maturiteti fillestar jepet ne vijim;

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2009 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Deri ne 30 dite** | | **31 -90** | | **91 -180** | | **181 -385** | | **Mbi 1 vit** | | **TOTAL** |
| Aktivet Afatshkurter | 754.448 | 0 | 1.111.645 | 0 | 0 | 0 | 1.250.378 | 0 | 927.140 | 0 | 4.043.611 |
| Aktivet Afatgajte | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 14.941.183 | 0 | 14.941.183 |
| **Total** | **754.448** | **0** | **1.111.645** | **0** | **0** | **0** | **1.250.378** | **0** | **15.868.322** | **0** | **18.984.793** |
| Detyrimet Afashkurter | 2.235.199 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.663.025 | 0 | 0 | 0 | 3.898.224 |
| Detyrimet afatgjate | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13.758.401 | 0 | 13.758.401 |
| Kapitali aksionr | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.328.169 | 0 | 1.328.169 |
| **Total** | **2.235.199** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **1.663.025** | **0** | **15.086.570** | **0** | **18.984.793** |
| **GAP me 31 dhjetor** | **-1.480.751** | **0** | **1.111.645** | **0** | **0** | **0** | **-412.647** | **0** | **781.753** | **0** | **1** |

Shumat ne mije Leke (perndryshe shkruhet)

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2008 | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Deri ne 30 dite** | | **31 -90** | | **91 -180** | | **181 -385** | | **Mbi 1 vit** | | **TOTAL** | |
| Aktivet Afatshkurter | 68.033 | 0 | 2.192.099 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 179.588 | 0 | 2.439.720 | |
| Aktivet Afatgajte | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 12.342.228 | 0 | 12.342.228 | |
| **Total** | **68.033** | **0** | **2.192.099** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **12.521.816** | **0** | **14.781.948** | |
| Detyrimet Afashkurter | 2.545.116 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.591.777 | 0 | 0 | 0 | 4.136.893 | |
| Detyrimet afatgjate | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 9.323.632 | 0 | 9.323.632 | |
| Kapitali aksionr | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1.321.424 | 0 | 1.321.424 | |
| **Total** | **2.545.116** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **1.591.777** | **0** | **10.645.055** | **0** | **14.781.948** | |
| **GAP me 31 dhjetor** | **-2.477.083** | **0** | **2.192.099** | **0** | **0** | **0** | **-1.591.777** | **0** | **1.876.760** | **0** | **0** | |

### *4.4 Manaxhimi i riskut të kapitalit*

Objektivat e Degës në lidhje me manaxhimin e kapitalit janë të ruajnë aftësinë e Degës për të vazhduar aktivitetin bazuar në parimin e vijimësisë me qëllim që të sjellë kthime për aksionerët. Me qëllim mbajtjen ose ndryshimin e strukturës së kapitalit. Njësoj si kompanitë e tjera që operojnë në këtë industri, Dega monitoron kapitalin e tij mbi bazën e normës gearing. Kjo normë llogaritet si raport i borxhit neto me kapitalin total. Borxhi neto llogaritet si total i huave (duke përfshirë huatë afatgjata dhe huatë afatshkurtra të paraqitura në bilancin kontabël) minus paratë dhe ekuivalentët e Mjeteve Monetare. Kapitali total llogaritet si vlera e kapitalit që paraqitet në bilanicn kontabël plus huanë neto. Normat gearing në 31 Dhjetor 2009 dhe 2008 ishin si më poshtë:

| | | **31-dhjet-09** | **31-dhjet-08** |
|---|---|---|---|
| Huate (note 21,22) | | 11.876.180 | 8.188.561 |
| Minus Mjetet Moneatre dhe te ngjashme ( shen 16) | | -281.159 | -68.033 |
| | Borxhi Neto | 11.595.021 | 8.120.528 |
| Fitimi ( Humbja) e mbartur | | 1.328.169 | 1.321.424 |
| | **Kapitali** | 12.923.189 | 9.441.952 |
| | **Gearing ratio** | **0,90** | **0,86** |

Nuk ka ndonje ndryshim te rendesishem te gearing ratios ne periudhen ushtrimore 2009 ne krahasim me 2008.

### *4.5 Vlerësimi i vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë e instrumentave financiare të tregtueshme në një treg aktiv (për shembull aktivet e mbajtura deri në maturim) përcaktohet duke përdorur çmimet e tregut në datën e bilancit kontabel. Çmimi i tregut i përdorur për aktivet financiare të mbajtura në maturim, është çmimi aktual për shitje që ka Dega. Vlera e drejtë e instrumentave financiarë që nuk tregtohen në një treg aktiv (p.sh. llogaritë e arkëtueshme) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Dega përdor një shumllojshmëri metodash dhe vendos supozime të cilat janë të bazuara në kushtet e tregut në datën e bilancit kontabël. Teknika të tjera, si p.sh parashikimi i flukseve monetare të skontuara përdoren për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të mbetura. Vlera e mbartur minus provizionet për rënie në vlerë të "të drejtave për t'u arkëtuar dhe detyrimeve për t'u paguar" supozohet që janë pouthuajse të njëjta me vlerën e tyre të drejtë. Vlera e drejtë e detyrimeve financiare për qëllime të shënimeve shpjeguese vlerësohet duke skontuar fluksin e ardhshëm të kontraktuar të parave me normën aktuale të interesit të tregut e cila është e vlefshme për instrumenta të ngjashme financiare. Ne fund te periudhes ushtrimore 2009 vlera e drejte e aktiveve dhe detyrimeve financiare eshte e perafert me vleren e tyre te mbetur.

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2009 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Aktive te mbajtura deri ne maturim** | **Kredi dhe paradhenie** | **Te tjera** | **TOTAL** |
| Aktivet Afatshkurter | 281.159 | 2.582.929 | 990.641 | 3.854.729 |
| Aktivet Afatgajte | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Total** | **281.159** | **2.582.929** | **990.641** | **3.854.729** |
| Detyrimet Afashkurter | 3.898.224 | 0 | 0 | 3.898.224 |
| Detyrimet afatgjate | 10.213.155 0 | 0 0 | 3.439.765 0 | 13.652.920 |
| Kapitali aksionr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Total** | **14.111.379** | **0** | **3.439.765** | **17.551.144** |

| | Periudha qe perfundoi me 31 dhjetor, 2008 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Aktive te mbajtura deri ne maturim** | **Kredi dhe paradhenie** | **Te tjera** | **TOTAL** |
| Aktivet Afatshkurter | 68.033 | 1.618.983 | 573.116 | 2.260.133 |
| Aktivet Afatgajte | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Total** | **68.033** | **1.618.983** | **573.116** | **2.260.133** |
| Detyrime Afashkurter | 4.053.855 | 0 | 0 | 4.053.855 |
| Detyrimet afatgjate | 6.453.721 0 | 0 0 | 2.726.847 0 | 9.180.569 |
| Kapitali aksionr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Total** | **10.507.577** | **0** | **2.726.847** | **13.234.424** |

## 5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Dega kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësyshme sipas rrethanave.

### *5.1 Monedha Funksionale dhe raportuese*

Monedha fuksionale e Deges eshte USD dollar. Vendosja e USD si monedhe fuksionale te Kompanise kerkojne gjykime te rendesishme. Ne marrjen e ketij gjykimi, merre ne konsiderate monedhen e mjedisit kryesor e ekonomike be te cilin operon. Dega gjithashtu merre ne konsiderat faktoret e meposhtem ne percaktimin e monedhes funksionale:

a) monedha

i. qe influencone kryesishte cmimin e shitjes per te mirat dhe shebimet ( jo eshte monedha ne te cilen cmimet e shitjes se te mirave dhe sherbimeve te saj jane percaktuar), dhe

ii. ku faktore ekonomike percaktojne cmimet e shitjes se te mirave dhe sherbimeve.

b) monedhat qe influencojne kryesishte fuqine puntore , materialet, dhe kosto te tjera te furnizimit te mallrave dhe shrbimeve (kjo eshte monedha me te cilen kosto te tilla jane percaktuar)

### *5.2 Shpenzimet e eksplorimit*

Shpenzimet e shpimit qe lidhen me eksplorimin qe jane kapitalizuar dhe jane te me te vjetra se 12 muaj jane kaluar ne shpenzime vetem kur (a) rezervat e provuara jane regjistruar ose (b) (i) jane gjetur sasi rezervash te prodhueshme dhe (ii) ato jane objekt i kerkimeve te metejshme ose aktiviteteve te vleresimit nderkohe qe shpimi i puseve te tjera per eksplorim eshte ne vazhdim ose i planifikuar per nje te ardhme te afert ose aktivitete te tjera jane duke u ndermarre ne menyre qe rezervat te behen te aksesueshme dhe te arrihet vlefshemeria operative dhe ekonomike e projektit. Per te marre vendimin per vazhdimin e kapitalizimit te shpenzimeve te kerkimit per nje periudhe me te gjate se 12 muaj eshte e nevojshme te behen gjykime per permbushjen e te gjitha kushteve te mesiperme. Nese ka ndryshim ne nje prej gjykimeve ne nje periudhe te ardhshme atehere kostot e kapitalizuara te lidhura ne kete gjykim duhet te ngarkohen ne shpenzimet e kesaj periudhe.

Gjate periudhes ushtrimore 2009 nuk ka shpenzime te eksplorimit ( 2008; 0).

### *5.3 Vleresimi i rezervave te naftes*

Rezervet e naftes dhe gazit jane elementi kyc ne procesin vendimarrjes se investimeve te Kompanise qe eshte e fokusuar ne rritjen e vleres. Gjithashtu ato jane fakor i rendesishem ne testimin e renies se vleres. Ndryshimet ne rezervat e provuara te naftes dhe gazit gjithashtu do te ndikojne ne masen e skontimit te flukseve te parase, gjithashtu keto ndryshime do te ndikojne ne harxhimin e njesive te prodhimit qe i ngarkohen te ardhurave.

Rezervat e provuara te naftes jane sasi te vleresuara te naftes bruto qe te dhenat gjeologjike dhe inxhinierike kane treguar me siguri te arsyeshme qe do te nxirren ne vitet e ardhshem nga rezervat e njohura nen kushtet ekonomike dhe operative, Psh. Cmimet dhe kostet e dates kur eshte bere vleresimi. Rezervat e provuara jane rezerva qe priten te nxirren nëpërmjet puseve dhe pajisjeve ekzistuese dhe metodave operative. Vlerësimet per rezervat e naftes dhe gazit jane te pasakta, ndaj kerkohet te kryerja e gjykimit dhe jane objekt i rishikimeve ne te ardhmen.

Prandaj, vleresimi financiar dhe kontabel( si vlerave te flukseve te parave te skontuara, zhvlerësimi, harxhimi dhe amortizimi dhe provizionet e *deccommissioning dhe restoration*) qe jane bazur ne rezervat e provuara jane gjithashtu objekte i ndryshimeve.

Ne pergjithsi, ndryshimet per rezervat e hidrokarbureve qe rezultojnë nga informacione te reja te bera te mundura nga aktiviteti I zhvillimit dhe I prodhimit bëhen shkak I rendesishem per rishikim e pervitshem. Ne përgjithësi, vlerësimi i rezervave për fusha te pazhvilluara apo pjesërisht te zhvilluara jane objekte i pasigurive te medha mbi jeten e tyre te ardhshme se vlersimet e rezervave per fushat qe jane kryesishte te zhvilluara dhe harxhuar.

Kur nje fushë fillon prodhimin, shumat e rezervave te provuara do te jene objekt i rishikimeve ne te ardhmen kur informacioni i shtuar behet i përdorshëm, nëpërmjet, per shembull, shpimet per shtimin e puseve ose vrojtimet e perfomances te rezervave afatgjate nen kushtet e prodhimit. Kur keto fusha jane ne zhvillim te mëtejshëm, informacioni i ri mund te drejtoj ne rishikime.

Ndryshimet e vlerësimeve te rezervave te provuara, rezervat e provuara te zhvilluara, gjithashtu ndikojnë shumat e zhvlerësimit, harxhimit dhe amortizimit te regjistruara ne Pasqyrat Financiare te per pronat,makineritë dhe pajisjet te lidhura me aktivitetin e prodhimit te hidrokarbureve. Keto ndryshime mund te jene rezultat per shembull i prodhimit dhe rishikimit te rezervave. Nje reduktim ne rezervat e provuara te zhvilluara do te rrisin normen e zhvlersimit, harxhimit dhe amortizimit te cilat ngarkojne dhe reduktojne te ardhurat.

Per me shume ne lidhje me vlerësimin e rezervave shenimi 26.

### *5.4 Renia ne vlere e aktiveve*

Per aktivet e naftes dhe gazit pa rezerva te provuara, kapitalizimi i kostove te kerkimit dhe bazat per shumat e mbartura per keto kosto ne bilancin kontabel jane sqaruar me siper. Pervec Aktiveve per te cilat nuk jane identifikuar rezerva te provuara ( ku baza per koston e mbartur eshte shpjeguar sipas " Kostot e Eksplorimit") vlera e mbartur e ndertesave, makineriveve dhe pajisjeve kryesore jane testuar cdo vit per renien ne vlere te mundeshme, atehere kur ngjarjet apo kushtet e gjendjes financiare te tyre tregojne qe shuma e mbartur e ketyre aktive nuk mund te rikuperohet. Ne Rast se per Aktivet identifikohen qe mbartin nje renie te vleres se tyre atehere shuma e mbartur ne kontabilitet zvogelohet deri ne shumen e rikuperueshme, e cila eshte shuma me e madhe midis vleres se drejte minus kostot e shitjes dhe vleres ne perdorim, ku kjo e fundit eshte llogaritur si vlera e skontuar e flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te rregulluara nga faktoret e riskut qe mbartin.

Per kete arsye grupohen sipas aftesise se tyre per te gjeneruar flukse hyrese te parase bazuar ne faktin qe keto aktive jane te identifikueshem vecmas dhe qe gjenerojne flukse te rendesishem mjetesh monetare.

Aktivet e klasifikuara si te mbajtura per shitje jane njohur me vleren me te voglen ndermjet vleres se mbartur dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Nuk ngarkohet asnje tjeter provizion per zhvlersimin per aktive te tille. Vlerësimi i flukseve te te ardhshme te parase eshte bazuar ne menaxhimin e vlersimit te cmimit te ardhshem te produktit, kerkesa dhe oferta e tregut, marzhi i produktit dhe ne rastin e aktiveve te naftes dhe gazit volumi i prodhimit te pritshem ne te ardhmen. Faktore te tjere qe munde te drejtojne ne dryshimet e vlersimit perfishin planet e ristrukturimit dhe variacionet ne rregullim e mjedisit. Sasite e prodhimit te pritura ne te ardhmen, te cilat perfshijne te dyja si rezervat e provuara po aq dhe sasite qe priten te formojne rezervat e provuara ne te ardhmen, jane perdorur per testimin e renies ne vlere sepse Dega e beson si indikatorin me te pershtatshem per flukset e ardhshme te parase, te cilat perdoren si mates te vleres ne perdorim. Vleresimet e flukseve te ardhshem te parase te perdorur ne vleresimin e renies ne vlere te aktiveve te lidhura me prodhimin e hidrokarbureve kryhet duke perdorur vlersimin e riskut ne fushat dhe performancen e rezervave dhe perfshijne pritjet ne lidhje me rezervat e provuara dhe sasive te paprovuara, te cilet vihen ne raport me riskun qe mbartin, duke perdorur rezultatet nga projektet gjeologjike, te prodhimit, te perpunimit dhe faktoret ekonomike.

Per testin e renies ne vlere eshte perdorur nje norme skontimi bazuar ne koston marxhinale te borxhit te kompanise. Kompania rishikon normen e skontimit qe do te aplikohet ne baza vjetore ndonese ajo ka qene stabel ne vitet e fundit. Norma e skontimit e aplikuar ne 2009 ishte 10 % ( 2008;10%).

Reniet ne vlere te aktivit dhe ndryshimet e tyre do te ndikojne te ardhurat, shumat jane paraqitur ne Shenimin 26. Faktoret qe ndikojne ne flukset e ardhshme te parase nga aktivet gjithashtu varen nga natyra e aktivitetit te biznesit ne te cilen po perdoren keto aktiveve dhe kushteve gjografike te tregut qe ndikojne ne bizneset ku perdoren keto aktive. Ky biznes dhe hapesira gjeografike e gjere eshte e tille qe nuk mund te zbatohet per te percaktuar mundesine apo madhesine e renies ne vlere ne tendencat e supozimeve te ndryshme.

Supozimet per cmimet e ardhshme te naftes tentojne te rrine stabel sepse Dega nuk i konsideron shtimet apo pakesimet afatshkurter te cmimeve si tregues te niveleve afategjate. Cmimet e ardhshme te perdorura ne testin e renies ne vlere jane percaktuar pas vlersimit te faktoreve; analizave historike, prirjet dhe paqendrueshmerite statistikore jane pjese e ketij vlersimi , po ashtu edhe anlizat e kushteve ekonomike te ardhshme globale dhe rajonale.

Gjate periudhës ushtrimore 2009 drejtimi testoi aktivet per vleren qe ato mbartin dhe mendon se nuk jane identifikuar faktore te cilët cojne ne nje ndryshim te vleres se aktiveve (2008;0) prandaj nuk ka efekte te testit te vleres te përfshira ne raportimin financiar. Cmimet e parashikuara per vleresimin e flukseve te ardhme te parase bazohen ne parashikimet e kompanise qe ka kryer vleresimin e reservave( shen 26) duke i rregulluar keto vlera me cilesine dhe shpenzimet e transportit duke i paraqitur si vijon;

| Viti | Cmimi Brent (US$/barrel) |
|---|---|
| 2009 | 55.00 |
| 2010 | 68.00 |
| 2011 | 78.00 |
| 2012 | 83.00 |
| 2013 | 86.00 |
| Rritja mesatare vjetor | 2% |

### *5.5 Renia ne Vlere e Llogarive te arkëtueshme*

Dega testoi për rënie në vlerë Llogaritë e Arkëtueshme në përputhje me politikat kontabël (Shënimi nr --). Vlera e drejtë u përcaktua për çdo llogari më vete bazuar në fluksit e parashikuar të parave të skontuar me normën e interesit të tregut. Vlera e drejtë është pothuajse e barabartë me vlerën e mbartur e si rrjedhim nuk u krijua asnjë provizion për rënie në vlerë për të drejtat për tu arkëtuar. Per me tej dega evidentoi klientin/et i cili rezulton me thyerje te kushteve kontraktuale te pageses se llogarive te arketueshme, duke evidentuar afatin e tejkaluar te arketimit nga klientet si vijon;

| Shumat ne '000 USD 31 Dhjet 2009 | Deri ne 30 dite | 30-60 | 61-180 | 181-360 | Mbi 1 vit | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Llogarite e Arketueshme | 0 | 0 | 833 | 13.050 | 3.446 | 17.330 |

| Shumat ne '000 USD 31 Dhjet 2008 | Deri ne 30 dite | 30-60 | 61-180 | 181-360 | Mbi 1 vit | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Llogarite e Arketueshme | 8,135 | 4,815 | 3,917 | 0 | 0 | 16,867 |

Ne pergjithesi dega ne Shqiperi e Bankers Petroleum konsideron si shkelje te marreveshjeve kontraktuore klientet te cilet rezultojne me shuma te papaguara mbi 30 dite. Drejtimi gjykon se nuk ka elementet qe te cojne ne zhvleresim te llogarive te arketueshme te mesiperme per te cilat ka vonesa per me shume se 30 dite. Keto shuma perfaqesojne te drejtat e arketueshme $17,300 mije (2008: $13,558 mije), ndaj nje kompani vendase per te cilat Bankers Petroleum Albania ka evidentuar gjate periudhes se aktiviteti te saj 2004- 2009 nje historik arketimesh i cili nuk ndryshon nga paraqitja e mesiperme.

### *5.6 Tatimi mbi të ardhurat*

Dega është subjekt i tatimit mbi të ardhurat. Në përcaktimin e provizioneve të tatimit mbi të ardhurat janë të nevojshme çmuarjet. Ekzistojnë shumë transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë gjatë veprimtarisë normale të biznesit. Dega njeh detyrimet për vlerësimet e organeve tatimore bazuar në vlerësimet nëse tatime të tjera shtesë do të lindin si detyrime. Nëse më pas ka diferencë midis detyrimit faktik dhe atij të regjistruar atëherë këto diferenca do të ndikojnë në tatimin mbi të ardhurat dhe provizionet për tatime në periudhën në të cilën është kryer ky krahasim.

### *5.7 Përfitime të tjera – Shperblimi me Aksione*

Duke perdorur metoden e vleres se drejte per Shperblimin me Aksione, Kompania llogarit shpenzimet per Shperblimet me Aksione qe me 31 Dhjetor 2009 ishin $831 mije (2008: $ 784 mije) per opsionet mbi aksionet e dhuruara nenpunesve te larte, drejtoreve apo punonjesve te Bankers Petroleum. Kompania percakton keto shuma duke perdorur modelin Black-Schole te zgjedhjes se cmimit me nje norme risku te lire interesi prej 2.67 deri 3.50% (2008: 2.67 deri 3.50%)

### *5.8 Krahasueshmëria*

Informacioni krahasues është paraqitur në përputhje me politikat konatëbl që zbatohen nga Dega. Janë bërë korigjimet e nevojshme për shifrat krahasuese në përputhje me ndryshimet në paraqitjet në periudhën aktuale.

## 6. Raportimi Segmentar

Segmentet e biznesit marrin parasysh shoqërinë në Dhjetor 2009 2 segmente biznesi që adresojnë prodhimin dhe shitjen e naftes bruto si dhe segmenti te tjera qe adreson aktivitetin administrativ e te pergjithshem te deges. .

-Raportimi i Segmentit ndjek të gjitha politikat kontabël që trajtuam dhe që përdoren për përgatitjen e Pasqyrave Financiare.

Tabela e mëposhtme paraqet informacionin për segmentet e biznesit të përshkruara si më siper.

Matja e performancës për secilin segment biznesi bëhet duke u bazuar në "të ardhurat (humbjet) nga aktiviteti operativ përpara kostove të ristrukturimit, rënies në vlerë të aktiveve të paprekshme:Segmentet e paraqitura më sipër të bizneseve janë identike me ato që paraqiten në informacionin që i jepet drejtimit.Informacioni mbi segmentet për periudhat e mëparshme është riparaqitur në përputhje me paraqitjet e periudhës aktuale, me qëllim që të reflektojë organizmin e shoqërisë në në datën e Bilancit.

| 31-dhjet-09 | Shitja e Naftes bruto | Te Tjera | TOTAL |
|---|---|---|---|
| **Te Ardhurat nga Veprimtaria baze** | | | |
| Te ardhurat (neto nga shpenzimet e transportit) | 7.202.148 | | 7.202.148 |
| Drejta Minerare (-) | (1.950.948) | | (1.950.94)8 |
| | **5.251.200** | | **5.251.200** |
| **Shpenzimet Operative** | | | |
| Shpenzimet e prodhimit | 2.334.228 | | 2.334.228 |
| Amortizimi, zhvleresimi dhe harxhimi | 1.505.417 | | 1.505.417 |
| Shpenzimet e rritjes se vleres se prov. per largimin e AAM | 28.806 | | 28.806 |
| Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative | | 428.638 | 428.638 |
| | | | 0 |
| **Fitimi (Humbja) para Rezultatit Financiar** | **1.382.750** | **(428.638)** | **954.111** |

| 31-dhjet-08 | Shitja e Naftes bruto | Te Tjera | | TOTAL |
|---|---|---|---|---|
| **Te Ardhurat nga Veprimtaria baze** | | | | |
| Te ardhurat (neto nga shpenzimet e transportit) | 8,472,040 | | | 8,472,040 |
| Drejta Minerare (-) | (1,898,865) | | | (1,898,865) |
| | **6,573,175** | | | **6,573,175** |
| **Shpenzimet Operative** | | | | |
| Shpenzimet e prodhimit | 2,454,731 | | | 2,454,731 |
| Amortizimi, zhvleresimi dhe harxhimi | 1,130,524 | | | 1,130,524 |
| Shpenzimet e rritjes se vleres se prov. per largimin e AAM | 20,271 | | | 20,271 |
| Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative | | 305,687 | | 305,687 |
| | | | | 0 |
| **Fitimi (Humbja) para Rezultatit Financiar** | **2,967,649** | **(305,687)** | **0** | **2,661,962** |

## 7. Te Ardhrat nga Shitja

Te Ardhurat nga shitja perfaqesojne te ardhuren qe rrjedh si pasoje e shitjes se naftes bruto. Kjo e ardhur eshte rregulluar per shpenzimet e shitjes.

| | Periudha ushtrimore qe u mbyll me 31 Dhjetor | |
|---|---|---|
| | **2009** | **2008** |
| Shitje Nafte Brutobrenda vendit | 825.270 | 4,384,009 |
| Eksporte te Naftes Bruto | 7.648.009 | 5,200,321 |
| Shpenzime te Shitjes | (1.271.131) | (1,112,290) |
| Te Ardhura te Tjera | | 0 |
| **Total** | **7.202.148** | **8,472,040** |

## 8. Shpenzimet per pagesat koncesionare

Keto shpenzime paraqesin shpenzimin e deges ne lidhje me te drejat minerare qe duhet te paguaje per shfrytezimin e puseve per prodhimin e naftes bruto.Te drejtat minerare ndahen ne disa kategori;

- Kompania paguan Albpetrolit pjesen e prodhimit para-egzistues nga puset e marre nga Albpetroli. Kjo pjese llogaritet per cdo pus duke perdorur 70% te prodhimit mesatar gjate 6 muajve te meparshem duke I korrektuar

ne zbritje me 15% per cdo vit. Gjithashtu termat e marreveshjes hidrokarbure perfshijne 1% te prodhimit per tu paguar Albpetrolit I cili rritet deri 3 dhe 5% (bazuar ne nje shkalle rritese) after mbulimit te kostove.

- Nga 20 Gushti I vitit 2008 taksa minerale (10%) ne shitjet u implementua nga shteti shqiptar miratuar me Ligjin Nr.9975 date 28.07.2008 i cili aplikohet ne shitjet bruto duke zbritur prodhimin para-egzistues

| | Periudha ushtrimore qe u mbyll me 31 Dhjetor | |
|---|---|---|
| | 2009 | 2008 |
| Drejtat Minerare dhe Paraeksistuese | 1.241.716 | 1.400.996 |
| Marreveshje e shitjes e Perbashket dhe Drejtat Minerale 10% | 709.232 | 497.869 |
| **Total** | **1.950.948** | **1.898.865** |

## 9. Shpenzime te përgjithshme Prodhimi

Keto shpenzime perfaqesojne shpenzimet direkte qe lidhen me procesin e prodhimit te naftes. Si rrjedhoje shoqëria ka perfshire kostot direkte te identifikuara si te tilla ; personeli, materiale, punime civile , qerate etj,

| | Periudha ushtrimore qe u mbyll me 31 Dhjetor | |
|---|---|---|
| | 2009 | 2008 |
| Shpenzime Prodhimi - punime nentokesore | 229.814 | 282,769 |
| Shpenzime Prodhimi - punime impjantet | 9.046 | 3,531 |
| Shpenzime Prodhimi - Materialet | 712.183 | 967,363 |
| Shpenzime Prodhimi - Transporti | 408.593 | 294,592 |
| Shpenzime Prodhimi - Sherbime dhe punime civile | 567.138 | 541,162 |
| Shpenzime Prodhimi - Pagat e Personelit | 539.010 | 491,119 |
| Shpenzime Prodhimi – Sherbime Te tjera | 133.233 | 382,297 |
| Shpenzime te tjera prodhimi | 4.463 | 6,432 |
| Shpenzime Prodhimi - Rishperndarje ne Aktivet | -269.252 | (265,308) |
| **Total** | **2.334.228** | **2,703,957** |

## 10. Shpenzime te pergjithshme administrative

